


# INDEKSI

## I TRANSPARENCËS PROAKTIVE TË INSTITUCIONEVE QENDRORE DHE TË VARËSISË



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

Raport Monitorimi  
Transparenca Proaktive dhe Indeksi i Transparencës  
i Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë

Monitorimi u krye nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Raporti u hartua nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

## Përmbajtja

<b>Hyrje</b> .....	4
<b>Metodologjia</b> .....	6
<b>Monitorimi</b> .....	8
<b>Gjetjet e Monitorimit</b> .....	12
<b>Indeksi i Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë</b> .....	13
<b>Gjetjet përfundimtare</b> .....	18

## Hyrje

E drejta për informim është e drejta e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimi i autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë pa kërkuar motivet. E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila pas miratimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka sjell një garanci më të madhe ligjore për aksesin e qytetarëve në informacion dhe kushtet e duhura të transparencës proaktive për të ushtruar të drejtat e tyre.

Një nga risitë e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është zbatimi i programeve të transparencës sipas Modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nëpërmjet Programit të Transparencës, i cili publikohet në faqen zyrtare, autoritetet publike vendosin në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre, si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar sipas Urdhrit nr. 14 datë 22.01.2015, “Programin Model të Transparencës” i cili është i detyrueshëm për të gjitha autoritetet<sup>1</sup> publike sipas përcaktimit të bërë në nenin 2 të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Një nga fazat e rëndësishme në sigurimin e transparencës në nivel qendror është edhe monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës. Monitorimi lejon të vlerësohet niveli i transparencës tek autoritetet publike. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyr respektimin e dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit dhe në rastet kur vërehen mosrespektimi i tyre, bën vlerësimin e kundërvajtjes dhe vendos masën administrative përkatëse.

Transparenca proaktive nëpërmjet publikimit të informacioneve në Programin e Transparencës kërkon një impenjimin të institucioneve publike për ta përditësuar dhe plotësuar me informacion në mënyrë të vazhdueshme. Për këtë arsye, monitorimi i transparencës të autoriteteve publike kryhet në bazë vjetore, duke lehtësuar kështu kryerjen e analizave krahasimore në të ardhmen. Zyra e Komisionerit ka kryer në mënyrë të vazhdueshme monitorim online të zbatimit të Programit Model të Transparencës tek autoritetet publike gjatë viteve duke vlerësuar tre kritere: “Publikimin e Programit Model të Transparencës”; “Publikimin e Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve” dhe “Publikimin e të Dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit”. Rezultatet e monitorimit

---

<sup>1</sup> Me përjashtim të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për të cilët është i detyrueshëm Programi Model i Transparencës sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

janë publikuar në raportet vjetore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ndër vite.

Gjatë vitit 2020, Zyra e Komisionerit ka vijuar me monitorimin online të zbatimit të Programit Model të Transparencës, Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve dhe të Dhënat e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit nga ana e autoriteve publike.<sup>2</sup> Gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit ka sjellë një metodologji të re të monitorimit të transparencës proaktive duke prodhuar dy raporte: Raporti i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Raporti i Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë, si dhe indekset respektive të transparencës proaktive. Raporti i monitorimit të transparencës proaktive të NJVV-e përfshin monitorimin e transparencës proaktive të 61 NJVV në 4 tregues kryesorë dhe gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Monitorimi i institucioneve qendrore dhe të varësisë, i cili ndjek një metodologji monitorimi të ngjashme me atë të raportit mbi transparencën proaktive të NJVV duke i shtuar një indikator të ri, është pilotuar në 36 autoritete publike duke përfshirë këtu Kryeministrinë, Ministrinë dhe disa institucione në varësi të ministrive.

Ky raport i cili lejon krahasimin midis autoriteteve publike, si dhe evidenton në mënyrë të qartë dhe saktë mangësitë në ato autoritete, të cilat nuk i kanë përmbushur detyrimet ligjore që burojnë nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe VKM 145/2018 “Për ngritjen e bazës së të dhënave shtetërore Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPMI)”.

Gjetjet e këtij monitorimi dhe indeksi synojnë jo vetëm të nxisin ndërgjegjësimin për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, si dhe rritjen e nivelit të transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit, por të shërbejnë dhe si një referencë përpara vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit në respektim të dispozitave ligjore.

---

<sup>2</sup> Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë vitit 2020 ka monitoruar online 417 autoritete publike (përfshirë këtu edhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore).

## Metodologjia

Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 5 treguesve kryesorë të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të transparencës proaktive të autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë. Numri total i pikëve të vlerësimit të treguesve është 5 (pesë). Bazuar në pikëzimin e çdo treguesi llogaritet shuma totale e vlerësimit për secilin institucion.

Instrumentet kryesore për matjen e transparencës proaktive janë publikimi i Programit Model të Transparencës në faqen zyrtare të autoriteteve publike dhe regjistrimi në bazën e të dhënave shtetërore “Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDI)”. Kërkimi në internet është përdorur për të vlerësuar treguesit duke vlerësuar gjendjen reale në momentin e kërimit.

### **Treguesi i parë**

*Publikimi i Programit Model të Transparencës për Autoritetet Publike*

Pikët:

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk ekziston

1 - informacioni ndodhet i publikuar

### **Treguesi i dytë**

*Publikimi i Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve i përditësuar gjatë vitit 2020*

Pikët:

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk ekziston

1 - informacioni ndodhet i publikuar

### **Treguesi i tretë**

*Emër Mbiemër Koordinatori për të Drejtën e Informimit*

Pikët:

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk ekziston

1 - informacioni ndodhet i publikuar

### **Treguesi i katërt**

*Publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2020*

Pikët:

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk ekziston

1 - informacioni ndodhet i publikuar

### **Treguesi i pestë**

*Regjistri Elektronik për Kërkesat dhe Përgjigjet për të Drejtën e Informimit i instaluar*

Pikët:

Vlerësimi: 0 - informacioni nuk ekziston  
1- informacioni ndodhet i publikuar


Ky sistem matje i transparencës proaktive ngjan me një sistem semafori.

Autoritetet Publike që i kanë të gjithë treguesit negativ dhe për këtë arsye kanë grumbulluar 0 pikë, kanë një transparencë proaktive negative dhe në semafor janë shënuar me dritë të kuqe.

Autoritetet Publike që kanë 1 nga 5 treguesit e monitorimit pozitiv, pra të vlerësuar me 1 pikë ndërsa 4 të tjerët janë vlerësuar me 0 pikë, kanë një transparencë proaktive të pamjaftueshme dhe në semafor janë shënuar me dritë të verdhë.

Autoritetet Publike që kanë grumbulluar 2 - 4 pikë, pra që kanë minimumi 2 tregues pozitiv dhe maksimumi 4 tregues pozitiv, kanë një transparencë proaktive minimale dhe në semafor janë shënuar me dritë të bardhë.

Autoritetet Publike të cilat i kanë të gjithë treguesit pozitiv dhe kanë grumbulluar 5 pikë kanë një transparencë proaktive funksionale dhe në semafor janë shënuar me dritë të gjelbër.



Semafor i Kuq = 0 pikë

Semafor i Verdhë = 1 pikë

Semafor i Bardhë = 2 - 4 pikë

Semafor i Gjelbër = 5 pikë

## Monitorimi

	<b>Autoriteti Publik</b>	<b>Programi i Transparencës</b>	<b>Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve</b>	<b>Koordinatori</b>	<b>Buxheti 2020</b>	<b>Regjistri elektronik</b>	<b>Total</b>
1	<b>Kryeministria</b>	1	1	1	0	1	4
2	<b>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme</b>	1	1	1	0	1	4
3	<b>Ministria e Mbrojtjes</b>	1	1	1	0	1	4
4	Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura <sup>3</sup>	1	1	1	0	1	4
5	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE)	1	0	0	0	0	1
6	<b>Ministria e Brendshme</b>	1	1	1	0	1	4
7	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit	0	0	0	0	0	0

<sup>3</sup> Transparenca proaktive e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura është pjesë e transparencës proaktive të Ministrisë së Mbrojtjes.




8	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	1	1	1	1	5
9	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1	1	1	1	0	4
10	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1	0	1	0	0	2
11	Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit	0	0	1	0	0	1
12	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	1	1	0	1	4
13	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	1	1	1	0	1	4
14	Autoriteti Rrugor Shqiptar	1	0	1	0	0	2
15	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	1	1	1	0	0	3
16	Autoriteti i Aviacionit Civil	1	1	1	0	0	3
17	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	1	1	1	1	5
18	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar	0	0	0	0	0	0

19	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	1	0	1	0	0	2
20	Qendra e Shërbimeve Arsimore	1	1	1	1	0	4
<b>21</b>	<b>Ministria e Drejtësisë</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>5</b>
22	Agjencia e Trajtimit të Pronave	1	1	1	1	0	4
23	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	1	0	1	0	0	2
24	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	1	0	1	0	0	2
<b>25</b>	<b>Ministria e Kulturës</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>5</b>
26	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore	0	0	1	0	0	1
<b>27</b>	<b>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>5</b>

28	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	1	1	1	0	0	3
29	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	1	0	0	0	0	1
30	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	0	1	0	1	3
31	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	1	0	0	0	0	1
32	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	1	0	1	0	0	2
33	Shërbimi Social Shtetëror	1	1	1	0	0	3
34	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	0	1	0	1	3
35	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	1	0	1	0	0	2
36	Agjencia Kombëtare e Turizmit	1	0	0	0	0	1
	<b>Total</b>	<b>32</b>	<b>19</b>	<b>30</b>	<b>8</b>	<b>14</b>	

## Gjetjet e Monitorimit

Rezultati i Semaforit sipas metodologjisë së studimit:



Numri total i autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë që kanë të publikuar Program Transparence është 32 përkundrej 36 autoriteteve të monitoruara.

Numri total i autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë që kanë përditësuar Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve për vitin 2020 është 19 përkundrej 36 autoriteteve të monitoruara.

Numri total i autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë që kanë publikuar të dhënat e koordinatorit për të drejtën e Informimit është 30 përkundrej 36 autoriteteve të monitoruara.

Numri total i Autoriteteve publike që kanë publikuar buxhetin e vitit 2020 është 8 përkundrej 36 autoriteteve të monitoruara.

Numri total i Autoriteteve publike që kanë instaluar regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve është 14 përkundrej 36 autoriteteve të monitoruara.

## Indeksi i Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë

Institucionet qendrore dhe ato të varësisë janë renditur në Indeksin e Transparencës Proaktive sipas rezultateve të monitorimit bazuar në metodologjinë e semaforit, duke vendosur në fillim të listës autoritetet publike të cilat kanë grumbulluar 5 pikë, më poshtë ato njësi të cilat kanë grumbulluar 4 pikë, pastaj ato me 3 pikë, poshtë tyre ato me 2 pikë, të parafundit ato me 1 pikë dhe në fund ato me 0 pikë.

Renditja e autoriteteve publike brenda të njëjtit grupim me të njëjtin numër pikësh është e rastësishme.

	Autoriteti Publik	Programi i Transparencës	Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve	Koordinatori	Buxheti 2020	Regjistri elektronik	Total
1	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	1	1	1	1	5
2	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	1	1	1	1	5
3	Ministria e Drejtësisë	1	1	1	1	1	5
4	Ministria e Kulturës	1	1	1	1	1	5

5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	1	1	1	1	1	5
6	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	1	1	1	0	1	4
7	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	1	1	0	1	4
8	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	1	1	1	0	1	4
9	Agjencia e Trajtimit të Pronave	1	1	1	1	0	4
10	Kryeministria	1	1	1	0	1	4
11	Ministria e Mbrojtjes	1	1	1	0	1	4
12	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1	1	1	1	0	4
13	Qendra e Shërbimeve Arsimore	1	1	1	1	0	4

14	Ministria e Brendshme	1	1	1	0	1	4
15	Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura	1	1	1	0	1	4
16	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	1	1	1	0	0	3
17	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	0	1	0	1	3
18	Shërbimi Social Shtetëror	1	1	1	0	0	3
19	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	0	1	0	1	3
20	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	1	1	1	0	0	3
21	Autoriteti i Aviacionit Civil	1	1	1	0	0	3
22	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1	0	1	0	0	2
23	Autoriteti Rrugor Shqiptar	1	0	1	0	0	2

24	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	1	0	1	0	0	2
25	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	1	0	1	0	0	2
26	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	1	0	1	0	0	2
27	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	1	0	1	0	0	2
28	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	1	0	1	0	0	2
29	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksperteve (AKSHE)	1	0	0	0	0	1
30	Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit	0	0	1	0	0	1
31	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore	0	0	1	0	0	1
32	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	1	0	0	0	0	1
33	Agjencia Kombëtare e Turizmit	1	0	0	0	0	1



34	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	1	0	0	0	0	1
35	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit	0	0	0	0	0	0
36	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar	0	0	0	0	0	0
	<b>Total</b>	<b>32</b>	<b>19</b>	<b>30</b>	<b>8</b>	<b>14</b>	

## Gjetjet përfundimtare

Në përfundim të monitorimit të transparencës proaktive vërejmë se autoritetet publike qendrore dhe të varësisë kanë një qëndrueshmëri të transparencës proaktive në indikatorët e “Publikimi i Programit Model të Transparencës” dhe “Publikimi i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit”. Për sa i përket tre indikatorëve të tjerë “Përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve për vitin 2020”, “Publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2020” dhe “Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDI)”, vihet re se ka një performancë më të ulët të transparencës.

Rezultatet e këtij monitorimi tregojnë se janë 32 autoritete publike qendrore dhe të varësisë që kanë publikuar “Programin Model të Transparencës (qoftë edhe formalisht)” sipas *Urdhrit nr. 14 datë 22.01.2015 “Programin Model të Transparencës”*, i cili është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga autoritetet publike, çka përben rreth 89% të autoriteteve publike pjesë e monitorimit. Në të njëjtën prirje është edhe indikator i “Publikimit të të Dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit” me 30 autoritete publike qendrore dhe të varësisë të cilat i kanë publikuar, çka përben 83% e totalit të autoriteteve publike.

Në lidhje me regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, monitorimi evidenton me pikë pozitive vetëm ato raste kur regjistri është përditësuar gjatë vitit 2020. Numri total i autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë të cilët kanë përditësuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve është 19, çka përben 53% të autoriteteve publike që kanë zbatuar detyrimin ligjor për përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Ndërkohë, që 14 autoritete publike (39%) kanë instaluar dhe janë bërë pjesë e Regjistrit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPDI). Indikator i cili rezulton me performancën më të ulët është indikator i “Publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2020”, ku vetëm 8 autoritete publike e kanë publikuar, çka përben 22% të totalit të autoriteteve publike pjesë të këtij monitorimi.



Për sa i përket indeksimit të transparencës proaktive midis autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë, sipas monitorimit rezulton se 2 autoritete publike (5%) kanë “Transparencë Proaktive Negative” (semafor i kuq), pra i kanë të gjithë treguesit negativ dhe për këtë arsye kanë grumbulluar 0 pikë; 6 autoritete publike (17%) kanë “Transparencë Proaktive të Pamjaftueshme (semafor i verdhë), sepse kanë 1 nga 4 treguesit e monitorimit pozitiv, ndërsa 3 të tjerët janë vlerësuar me 0 pikë; 23 (64%) autoritete publike kanë “Transparencë Proaktive Minimale (semafor i bardhë), sepse kanë minimumi 2 tregues pozitiv dhe maksimumi 4 tregues pozitiv, si dhe 5 autoritete publike (14%) kanë “Transparencë Proaktive Funktionale” (semafor i gjelbër) sepse kanë të gjithë treguesit pozitiv.